

Mission ynë:
Mbështetja e mundësive për përmirësimin e arsimit të fëmijëve dhe të rinjëve të rajonit të izoluar të Malësisë së Madhe të Shqipërisë së Veriut.



President: Steve Cook, PhD

Secretary: Terri Cook

Board of Directors:

Karen Berg
Mary Alice Seville
Nancy Leeper
Kristina Milaj
Mona Jones-Romansic

Albania Manager:
Marash Rakaj

Nga Presidenti:

Në qershor udhëtova në Shqipëri për herë të parë pas katër vjetësh. Ishte shumë mirë të takoj përsëri miqtë e mi. Kanë kaluar tridhjetë vjet që nga vizita ime e parë në Shqipëri dhe njëzet vjet që kur gruaja ime Terri, kolegu im shqiptar, Profesor Marash Rakaj, dhe unë krijuam Institutin e Alpeve Shqiptare. Njëzet vjet! Ne parashikonim që ky mision të ishte për një kohë të gjatë, dhe ne e cilësuam "afat-gjatë" si një periudhë dhjetëvjeçare. Por donatorët vazhdojnë të mbështesin programet tona arsimore në veri të Shqipërisë. Është kënaqësi e rallë të shohësh fëmijë, veçanërisht vajzat, që pëmbushin ëndrrat e tyre për shkollim.

AAI sponsorizoi një konkurs/festë në Dedaj gjatë kohës që isha atje. Kishim konkurrencë në muzikë, art, kërcim dhe volejball. Ne paguam dy autobusa për të sjellë studentë nga Kelmendi. Kishte rreth njëqind nxënës dhe tridhjetë mësues. Të gjithë ia kaluam mirë, dhe në fund, kishte tortë dhe akullore për të gjithë. Vazhdo në *faqen tjetër...*

APLIKANTËT PËR BURSË UNIVERSITARE– 2022-2023

Urime dhe fat të mbarë të gjithë bursistave të AAI!

Marisilda Pllumaj – Bachelor, Fizioterapi
Rozela Malotaj – Bachelor, Fizioterapi
Armando Bakaj – Bachelor, Administrim Biznesi
Marin Malotaj – Bachelor, Inxhinieri Ndërtimi
Kristjan Pllumaj – Bachelor, Informatikë
Ernest Gjellaj – Bachelor, Matematikë
Mikel Rakaj – Bachelor, Administrim Biznesi
Xhesika Bakaj – Masters, Financë/Kontabilitet
Ermela Celaj – Masters, Financë/Kontabilitet
Ledi Marinaj – Masters, Anglisht
Stela Vulaj – Masters, Matematikë
Xhulja Vulaj – Shkollë e Mesme

Albanian Alps Institute
8600 NW Oak Creek Drive
Corvallis, OR 97330

Phone: 541-230-1285
Email: albanianalpsinst@gmail.com
Website: www.albanianalps.org

Nga Presidenti, vazhdim...

Pas festës, AAI sponsorizoi një darkë për nxënësit e universitetit që ndihmuan me organizimin e konkursit, mësuesit, dhe disa zyrtarë nga Kopluku. Në një ceremoni të vogël pasuese, mua më nderoi Bashkia e Malësisë së Madhe me një çmim "Për kontributin e dhënë në promovimin e turizmit, mbështetjen e arsimit dhe ngritjen e kapaciteteve në komunitetin e Malësisë së Madhe të Alpeve". Isha i nderuar dhe njëkohësisht i përulur. Në vitin 2021, AAI zgjeroi zonën tonë duke përfshirë edhe shkollat e krahinës së Kelmendit, përtej maleve në veri dhe në lindje të Shkrelit. Gjatë këtij udhëtimi shkova të vizitoja shkollat e Kelmendit dhe u largova i mahnitur nga mësuesit që takova.

Dhe asgjë nga këto nuk mund të ndodhë pa donacionet tuaja bujare. Ju po ndihmoni në ndryshimin e jetës së njerëzve, dhe unë dhe studentët nuk mund t'ju falënderojmë sa duhet.



Nxënësit e Kopshtit, Sencë



Shkolla 9-vjeçare Vukël



Nxënësit e Kopshtit, Bogë



Vizita e Profesor Steve në Kopshtin e Vrithit



Nxënësit e Anglishtes, Vrith



Shkolla 12-vjeçare Tamare

amazon smile
Org Central

Amazon Smile është një mënyrë e thjeshtë dhe automatike për të mbështetur organizatën tuaj të preferuar bamirëse, pa ju kushtuar juve asnjë lek. Kur blini në smile.amazon.com, ju do gjeni ekzaksisht të njëjtat produkte dhe çmime si në Amazon.com, por me bonus, sepse Amazon do të dhurojë 0.5% të çmimit të artikujve që ju blini për organizatën tuaj të preferuar.

Herën e parë që shkoni në smile.amazon.com, hyni një lloj si tek Amazon.com. Atëherë përzgjidhni organizatën bamirëse që ju dëshironi të mbështesni (shpresoj që të jemi ne). Amazon e mban mend zgjedhjen tuaj dhe ç'do blerje e juaja nëpërmjet smile.amazon.com rezulton në një donacion nga Amazon për organizatën që ju zgjodhët. Vetëm mbaj mend të shkoni në smile.amazon.com, hyr si zakonisht dhe vazhdoni blerjen!